

Kosova dhe Enver Hoxha
Esat Myftari

Parathanje

I ndodhun para interpretimeve të ndryshme rreth ngjarjeve të viteve 1968 dhe 1981, e pashë të arsyeshme me qëmtue nëpër dosjet diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, me shpresën se kam me gjetë mjaft materiale që ndihmojnë të zbriten disa momente të randësishme të saj. Sigurisht që kisha edhe një lloj interesi e nostalgjie vetjake për këtë lloj hulumtimi, mbasi më takoi të merrem gjatë me këtë problematikë. Nga kjo pikëpamje, kuptohet, isha i përfshimë edhe emocionalisht. Nëpër ato fletë që kajherë mbajnë edhe erë myku, unë ndesha në ngjarje, zhvillime politike e kulturore, emna njerëzish të njohun personalisht ose të ndigjuem, të cilët drejtpërdrejt ose tërthorazi përbanin motivin dhe objektivin e raportimeve të diplomatëve shqiptarë, sidomos të atyne të akredituem në Beograd, Vjenë, Ankara, Stamboll e Paris.

Nji numër jo i pakët nga kjo galeri personazhesh tashma nuk janë gjallë. Po ata rishfaqen si në një kaleidoskop të stërmadh: oficerë që janë marrë në mënyrën e tyne me rezistencën kosovare, veprimtarinë klandestinë nëpër Europë e ma tej, të rinj që vëjtën nëpër burgjet jugosllave e shqiptare për shkak të Kosovës, ish shokë shkolle e të gazetës “Rilindja”, me të cilët kisha punue për një kohë të shkurtë në Prishtinë, por që kur vinin si vizitorë privatë ose në përbamje delegacionesh bartnin me vete transfigurimet e kohës a interesit, por edhe të tjerë që kishin ruejt tiparet e fisme të rinisë, pothuej të paprekuna prej viteve e baltës që hedhin ato.

Dokumentet që janë shfrytëzue për këtë libër janë kryesisht raportimet e diplomatëve tanë, por të shkrime në sfondin e përvojës dhe vëzhgimeve vetjake përgjatë një gjys shekulli si “emigrant kosovar”. Veç kësaj, duhet pasë parasysh se raportimet janë ba prej diplomatëve tanë ideologjikë, me hapësinë fort të ngushtueme manovrimi a nisme vetjake. Por gjaja tjetër që bie në sy e që të befason megjithatë për mirë, asht përmbajtja e këtyne raportimeve: në to nuk ka aq fanatizëm ideologjik sa kisha kujtue, madje herë-herë ka një shqetësim atdhetar e objektiv të pasqyruem qartë, përjashtoj disa epitete në trajtën e klisheve të pëlqyeshme për veshin e eprorëve të tyne. E, në këtë pikë, ata janë të zotë e të ftohtë. Sidoqoftë, për shkak të vendeve ku shërbenin dhe natyrës së kontakteve të tyne njerëzore, përzgjedhja e diplomatëve tanë ka pasë një karakter specifik: atje qenë emnue, sidomos në momente delikate, përgjithësisht njerëz që kishin shërbye në organet sekrete shqiptare e që e njihnin nga afër problemin shqiptar dhe *strukturën e gjallë të saj*.

Në këtë frymë e praktikë të njohun, vend të spikatun zinte nomenklatura shqiptare e Kosovës. Po edhe midis anëtarëve të saj kishte një ndamje jo vetëm kohore por edhe mentaliteti. Fadil Hoxha, Ali Shukria, Veli Deva, Xhavit Nimani, Ismet Shaqiri, ishin kuadro të dala nga lufta, por edhe persona të shkolluem në Shqipëri e me njohje apo miqësi personale me udhëheqjen e saj komuniste. Prandaj, në varësi prej fazave, ata janë herë ma të shënjestruem për politikën zyrtare të të dy palëve, herë ma të pëlqyem prej tyne, por gjithsesi me vullnetin e të dy qeverive, asaj jugosllave e shqiptare – të përhershëm. Nga ana tjetër kemi Mahmut Bakallin, Asllan Fazllin, Ismail Bajren, Azem Vllasin etj., që janë për një brez ma të rinj dhe me kontribute vetëm të mbasluftës, pra kuadro me karrierë të fitueme në rrethana të tjera, sigurisht ma të sigurtë e moralisht ma pak sfiduese. Megjithatë, ndër të dy këto kategori funksionarësh, veçohet Fadil Hoxha, për të cilin formalisht qarkullonin opinione të dyzume. Sidoqoftë, për aq sa del prej këtyne materialeve, mund të thuhet: Mbas Plenumit të Brionëve dhe periudhës së demaskimit të krimeve serbe në Kosovë, të kryeme prej UDB-së së Serbisë dhe, kryesisht, mbas pushtimit të Çekosllovakisë nga BS, marrëdhëniet midis Shqipërisë e Jugosllavisë ndryshojnë shumë dhe Kosova, në këto kushte, kap një pozicion të ri, gjithsesi ma të favorshëm sesa në gjallje të Rankoviqit.

Prandaj kjo hapje, për Fadil Hoxhën me shokë të tij, shënonte daljen e tyre prej heshtjes, errësinës e pasivitetit në raport me Shqipërinë, pse atyne u rijepet roli i vjetër i *përçuesve*. U përtrinë me një dukë të re kredencialet e tyre të luftës dhe vetëm shfletimi i materialeve të deklasifikueme jugosllave mund të na zbulojë edhe anën tjetër të medaljes. Gjithësesi, kjo epokë mbetet tepër domethanëse, sepse laku kohor prej 1968-1981 në thelb nxiti e mundësoi procese të mëdha pozitive shoqërore, politike e kombëtare në Kosovë. Figura e Fadilit, komplekse siç janë në përgjithësi figurat e vasalëve modernë, na zbulohet pjesërisht edhe përmes bisedave të tija me ambasadorët shqiptarë të akredituëm në Beograd, prandaj ato që u gjetën janë dhanë të shpërndame gjithandej tekstit.

Në përputhje me praktikën e vendosur, të gjitha këto raportime kanë për adresë, në varësi të periudhave e zhvillimeve të mbrenshme në Shqipëri, Enver Hoxhën, Mehmet Shehun, Hysni Kapon dhe Ramiz Alinë, ndaj ato duhet të shqyrtohen me seriozitet sepse në mënyrë mjaft grafike tregojnë nënshtresat e anmiqësive formale dhe miqësive informale, ku Fadili asht hallkë e dobishme për të dyja palët. Jo për kompetencat e aftësit që kishte, por për origjinën dhe rrugën e jetës së tij.

Personi tjetër me shumë randësi në këto “meridiane shqiptare”, asht pa dyshim Prof. Bujar Hoxha. Ai do të bjen në sy veçan në ditët e jubileut të 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut në Prishtinë. Delegacioni shqiptar vërtetë kishte njerëz edhe ma të naltë si rang se sa ai, por Bujari që caktue aty në rolin e *factotum*-it¹ të Enver Hoxhës. Detyra e tij e parë ishte të kanalizonte kërkesat politike të kosovarëve mbas largimit të Rankoviqit dhe hapjes së Titos ndaj Shqipërisë e Kosovës, sidomos kur ideja “Kosova Republikë” kishte marrë karakter masiv e po shtrohej në kulisa politike me shanse reale. Jo vetëm kaq, por që nga ky moment ai do të vazhdonte të ishte njeriu ma i besueshëm i shtetit shqiptar për të gjitha shqetësimet madhore që lidheshin me Kosovën e që kërkonin një medium kosovar. Për këtë shërbim, një të dytë si ai nuk ka pasë. Sidomos raportimet e tij mbas dështimit të revoltës së vitit 1981, kohë kur kërkohej njëjtësimi i aktorëve të saj, i shkaqeve të dështimit dhe i menaxhimit të tij, përbajnë një material interesant studimi sepse zbulojnë profilin e grupeve marksiste-leniniste, të cilat mendohen si shumë veprues në revoltën e vitit 1981.

Kam pasë kënaqësi të veçantë me e ndjek itinerarin politik të Mahmut Bakallit. Përkufizimit të ambasadorit italian Xhentilini se “ai asht politikani ma me vizion i Kosovës” i shtohet edhe guximi i tij qytetar e intelektual në momentet ma produktive për të. Një *bon viveur*² që në kulmin e provës iu përkul virtutit dhe ndërgjegjës kombëtare.

Përveç këtij rrethi politikanësh, por jo plotësisht jashtë tij, vijnë korifejtë e profesoratit të ri kosovar: Dr. Dervish Rozhaja, Dr. Musa Haxhia, Dr. Syrja Pupovci, Dr. Gazmend Zajmi, Dr. Fehmi Agani etj., të cilët çelën epokën e përpunimit shkencor e kulturor të ndërveprimit gjithëshqiptar, së bashku me personalitetet e shqueme shkencore të Shqipërisë: Dr. Eqrem Qabejn, Dr. Aleks Budën, Dr. Kahreman Yllin, Dr. Osman Krajën, Dr. Kolë Popën etj., me të cilët do të përbanin plejadën e paharrueshme të asaj kohe. Sigurisht që shqetësimi dhe detyra e parë e tyre ishte gjallnimi e profesionalizimi i arsimit dhe kulturës shqiptare në Kosovë, por ata shkonin edhe ma përtej këtij pragu, ata modulonin një të ardhme të përbashkët kombëtare, përkundër diktateve etatiste dhe kufizimeve të kohës.

Një vend i veçantë i takon Jusuf Gërvallës, këtij talenti poliedrik që, me sa kuptojmë, dhuntí kryesore nuk e kishte politikën. Ai dha gjithçka që pati për Kosovën e tij të shtrenjtë dhe dhimbja për këtë humbje të madhe vjen e na shtohet kur marrim vesh se cilin ia kishin caktue zyrtarisht për *mirëbesim*, të paktën në fazën e hershme të angazhimit të vet politik. Relacionet ende të padeklasifikueme të Engjëll Kolanecit do të na ndriçonin mjaft mistere – nëse jo të gjitha – rreth fatit tragjik të treshes së Shtutgartit dhe përgjithësisht të diasporës kosovare në arealin gjermanishtfolës, ku ai ishte njeriu i kontakteve *diskrete*.

¹ *factotum* – dorë e djathtë; shërbyes që merret me të gjitha (shën. i aut.).

² *bon viveur* – person që dëshiron t’i shijojë gëzimet e jetës, dëfrimet; qejfli (shën. i aut.).

Autori